

MARRËVESHJE ADMINISTRATIVE
MBI ZBATIMIN E MARRËVESHJES
PËR MBROJTJEN SHOQËRORE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE DUKATIT TË MADH TË LUKSEMBURGUT

Në zbatim të paragrafit 2 të nenit 18 të marrëveshjes në fushën e mbrojtjes shoqërore mes Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut, nënshkruar në Luksemburg, më 27 tetor 2014, autoritetet kompetente kanë vendosur, me një marrëveshje të përbashkët, dispozitat e mëposhtme :

KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

1. Për zbatimin e kësaj marrëveshje administrative

a) Termi « marrëveshje» nënkupton Marrëveshjen për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të madh të Luksemburgut, nënshkruar në Luksemburg, më 27 tetor 2014 ;

b) Termi « marrëveshje administrative» nënkupton marrëveshjen administrative të mëposhtme.

2. Termat e përdorura në këtë marrëveshje administrative përdoren në kuptimin që i atribuohen nga neni 1 i marrëveshjes.

Neni 2

Organet ndërlidhëse

1. Në bazë të paragrafit 3 të nenit 18 të marrëveshjes do të caktohen si organizma ndërlidhës:

Për Republikën e Shqipërisë :

- Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Për Dukatit të Madh të Luksemburgut:

- Inspektoriati i përgjithshëm i Sigurimeve shoqërore

2. Për zbatimin e marrëveshjes organizmat ndërlidhës të caktuar në paragrafin 1 mund të komunikojnë drejtpërsëdrejti mes tyre si dhe me personat e interesuar ose përfaqësuesit e tyre.

3. Organizmat ndërlidhës bien dakord për procedurat e përbashkëta dhe formularët e nevojshëm për zbatimin e marrëveshjes dhe të kësaj marrëveshjeje administrative.

Neni 3

Institucionet kompetente

Për zbatimin e ligjeve të parashikuara në paragrafin 1 të nenit 2 të marrëveshjes, janë përcaktuar si institucione kompetente.

A. Për Republikën e Shqipërisë :

1. Për përfitimet në para të pensioneve të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar si dhe për punëdhënësit :

– Instituti i Sigurimeve Shoqërore

2. Për përfitimet në natyrë të sigurimit vullnetar të kujdesit shëndetësor :

– Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

B. Për Dukatin e madh të Luksemburgut :

1. për sa i përket sigurimit të pensionit në rastin e pleqërisë, të paaftësisë në punë dhe pensionit familjar:

- Fondi Kombëtar i Sigurimeve të Pensionit
- Administrata e personelit të Shtetit, departamenti i personelit në pension
- Fondi për parashikimin e paaftësisë të funksionarëve dhe nëpunësve të komunave,
- Shoqëria kombëtare e hekurudhave luksemburgase, departamenti i personelit në pension

2. për zbatimin e nenit 8 të Pjesës I dhe Pjesës II të marrëveshjes :

– Qendra e përbashkët e sigurimeve shoqërore

3. për sa i përket konstatimit të paaftësisë në punë :

– Kontrolli mjekësor i sigurimeve shoqërore

Neni 4

Vërtetimi lidhur me bashkimin e periudhave të sigurimeve

1. Në zbatim të nenit 6 të marrëveshjes dhe për sa i përket zbatimit të neneve 14 deri më 16 të marrëveshjes, nëse për përfitimin, mbajtjen dhe mbulimin e të drejtave të përfitimeve, është e nevojshme të konsiderohen periudhat e sigurimit të kryera në bazë të legjislacionit të Shtetit tjetër kontraktues, institucioni kompetent i këtij Shteti kontraktues përpilon një formular që vërteton periudhat e sigurimit të plotësuara në bazë të legjislacionit që ai aplikon.

2. Ky formular përpilohet, ose me kërkesën e të interesuarit, ose me kërkesë të institucionit kompetent të Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit gjendet i interesuari.

A. Për Republikën e Shqipërisë :

1. Për përfitimet në para të pensioneve të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar si dhe për punëdhënësit :

– Instituti i Sigurimeve Shoqërore

2. Për përfitimet në natyrë të sigurimit vullnetar të kujdesit shëndetësor :

– Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

B. Për Dukatin e madh të Luksemburgut :

1. për sa i përket sigurimit të pensionit në rastin e pleqërisë, të paaftësisë në punë dhe pensionit familjar:

– Fondi Kombëtar i Sigurimeve të Pensionit

– Administrata e personelit të Shtetit, departamenti i personelit në pension

– Fondi për parashikimin e paaftësisë të funksionarëve dhe nëpunësve të komunave,

– Shoqëria kombëtare e hekurudhave luksemburgase, departamenti i personelit në pension

2. për zbatimin e nenit 8 të Pjesës I dhe Pjesës II të marrëveshjes :

– Qendra e përbashkët e sigurimeve shoqërore

3. për sa i përket konstatimit të paaftësisë në punë :

– Kontrolli mjekësor i sigurimeve shoqërore

Neni 4

Vërtetimi lidhur me bashkimin e periudhave të sigurimeve

1. Në zbatim të nenit 6 të marrëveshjes dhe për sa i përket zbatimit të neneve 14 deri më 16 të marrëveshjes, nëse për përfitimin, mbajtjen dhe mbulimin e të drejtave të përfitimeve, është e nevojshme të konsiderohen periudhat e sigurimit të kryera në bazë të legjislacionit të Shtetit tjetër kontraktues, institucioni kompetent i këtij Shteti kontraktues përpilon një formular që vërteton periudhat e sigurimit të plotësuara në bazë të legjislacionit që ai aplikon.

2. Ky formular përpilohet, ose me kërkesën e të interesuarit, ose me kërkesë të institucionit kompetent të Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit gjendet i interesuari.

Neni 5

Kërkesë për sigurimin shëndetësor vullnetar të vazhdueshëm

Në zbatim e paragrafit 2 të nenit 8 të marrëveshjes, institucioni kompetent i Shtetit kontraktues i cili merr një kërkesë sigurimi shëndetësor vullnetar të vazhdueshëm, mund t'i drejtohet, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet organizmave ndërlidhës, institucionit kompetent të Shtetit tjetër kontraktues për t'i kërkuar një formular që dëshmon periudhat e sigurimit të plotësuara në bazë të legjislacionit të këtij Shteti kontraktues.

KREU II – DISPOZITAT QE PËRCAKTOJNË LEGJISLACIONIN E ZBATUESHEM

Neni 6

Vërtetim lidhur me legjislacionin e zbatueshëm

1. Në rastet e parashikuara në nenin 10 dhe në paragrafin 1 të nenit 11 të marrëveshjes, institucioni kompetent i Shtetit kontraktues legjislacioni i të cilit është i zbatueshëm i jep punonjësit, me kërkesën e tij ose të punëdhënësit, një formular që vërteton se ai i nënshtrohet këtij legjislacioni. Formulari tregon periudhën e transferimit ose të punës së përkohshme në territorin e Shtetit tjetër kontraktues.
2. Institucioni që ka lëshuar formularin e përmendur në paragrafin 1 i dorëzon punonjësit dhe punëdhënësit një kopje të vlefshme dhe i adreson një kopje institucionit kompetent të Shtetit tjetër kontraktues. Punonjësit duhet të ruajnë formularin gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Shtetit tjetër kontraktues për t'ia paraqitur, nëse është e nevojshme, institucionit kompetent të këtij Shteti kontraktues.
3. Në rast ndërprerje të parakohshme të periudhës së transferimit ose të aktivitetit të përkohshëm të parashikuar fillimisht, punonjësi ose punëdhënësi duhet të informojë institucionin kompetent të Shtetit kontraktues në territorin e të cilit punonjësi është transferuar ose ka kryer përkohësisht një punë, me ndërmjetësimin e institucionit që ka lëshuar formularin.

KREU III – PLEQËRIA, INVALIDITETI DHE PENSIONI FAMILJAR

Neni 7

Paraqitja e kërkesave për përfitime

1. Për të marrë përfitime sipas dispozitave të pjesës III të marrëveshjes, aplikanti duhet t'i adresohet me një kërkesë institucionit kompetent të Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit ai banon, sipas modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni që ky institucion zbaton.

2. Nëse në momentin e paraqitjes së kërkesës, asnjë periudhë sigurimi nuk është përmbushur sipas legjislacionit të Shtetit kontraktues në territorin e të cilit aplikanti banon, institucioni kompetent duhet ta trasmetojë kërkesën e tij pa vonesë institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet organizmave ndërlidhës.

Neni 8

Trajtimi i kërkesave për përfitime

1. Institucionet kompetente të Shteteve kontraktuese i përcjellin njëri-tjetrit pa vonesë, drejtpërdrejtë dhe pa ndihmën e organizmave ndërlidhës, kërkesat si dhe çdo dokument tjetër të disponueshëm që mund të jetë i nevojshëm për trajtimin e kërkesës, sipas një formulari të përcaktuar me këtë qëllim. Çdo institucion kompetent përcjell gjithashtu një formular që i vërteton institucionit kompetent të Shtetit tjetër kontraktues, periudhat e sigurimit të plotësuara bazuar në legjislacionin e tij.

2. Para përcjelljes së përmendur në paragrafin 1, institucioni kompetent i Shtetit kontraktues që ka marrë një kërkesë për përfitime, vendos në kërkesë datën e hyrjes dhe vërteton saktësinë e të dhënave personale. Kjo procedurë zëvendëson dërgimin e dokumentave mbështetëse.

Neni 9

Njoftimi i vendimeve

Çdo institucion kompetent përcakton të drejtat e aplikantit sipas dispozitave të pjesës III të marrëveshjes dhe njofton të interesuarin për vendimin përkatës duke treguar procedurat dhe afatet kohore, duke i përcjellë njëkohësisht një kopje institucionit kompetent të Shtetit tjetër kontraktues.

Neni 10

Pagesa e pensioneve

1. Përfitimet në ngarkim të një institucioni kompetent të një Shteti kontraktues i paguhen drejtpërdrejtë përfituesit që banon në territorin e Shtetit tjetër kontraktues, në rastet e parashikuara nga legjislacioni që ky institucion zbaton.

2. Pagesa bëhet konform nenit 23 të marrëveshjes, pa asnjë zbritje për shpenzimet administrative që mund të kenë dalë gjatë pagesës së një përfitimi. Megjithatë, shpenzimet bankare janë në ngarkim të titullarit të pensionit.

3. Përfituesit duhet t'i transmetojnë institucionit debitor të përfitimit, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet institucioneve ndërlidhës, çdo vit, një certifikatë lindjeje të lëshuar nga autoritetet e Shtetit kontraktues në territorin e të cilit ata jetojnë.

Neni 11

Statistika

Organizmat ndërlidhës shkëmbejnë statistika vjetore mbi numrin e përfitimeve të paguara në Shtetin tjetër kontraktues si dhe mbi shumat përkatëse.

KREU IV – DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 12

Kontrolli mjekësor dhe administrativ

1. Në zbatim të paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 19 të marrëveshjes, kontrolli mjekësor dhe administrativ i përfituesit të një prej Shteteve kontraktuese, i cili banon në territorin e Shtetit tjetër kontraktues, kryhet me kërkesën e institucionit kompetent, nën kujdesin e institucionit të vendit të rezidencës, sipas modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni që ky institucion i fundit zbaton.

2. Me kërkesë të një institucioni kompetent të një prej Shteteve kontraktuese, institucioni kompetent i Shtetit tjetër kontraktues i komunikon falas çdo informacion të llojit mjekësor dhe çdo dokumentacion që posedon lidhur me paaftësinë e aplikantit ose të përfituesit të benefiteve.

3. Institucionet kompetente ruajnë megjithatë të drejtën të procedojnë me ekzaminimin e të interesuarit nga një mjek që e zgjedhin ata.

4. Shpenzimet që rezultojnë nga kontrolli administrativ, si dhe nga analizat mjekësore, mbajtjet në vëzhgim, udhëtimet e mjekëve dhe sondazhet administrative apo mjekësore të nevojshme për dhënien, shërbimin apo rishikimin e përfitimeve, i rimbursohen institucionit që i ka patur në ngarkim, në bazë të tarifës që ai aplikon, nga ana e institucionit për llogarinë e të cilit ato janë kryer.

5. Organizmat ndërlidhës të të dy Shteteve kontraktuese mundën, që me dakordësinë e autoriteteve kompetente respektive, të heqin dorë nga rimbursimi i shpenzimeve të përmendura në paragrafin 4.

Neni 13

Shkëmbimi i informacioneve

1. Përfituesit në bazë të legjislacionit të një prej Shteteve kontraktuese që banojnë në territorin e Shtetit tjetër kontraktues i komunikojnë institucionit kompetent, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet organizmave ndërlidhës, çdo ndryshim lidhur me situatën e tyre personale apo familjare, gjendjen shëndetësore, aftësinë për punë, të ardhurat si dhe çdo rrethanë tjetër, që mund të ndikojë mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas legjislacioneve të përmendura në nenin 2 të marrëveshjes dhe sipas dispozitave të marrëveshjes.
2. Institucionet komunikojnë me njëri-tjetrit, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet organizmave ndërlidhës çdo informacion analog për të cilën ato kanë dijeni.
3. Në komunikimet e tyre, institucionet kompetente preferojnë përdorimin e mjeteve elektronike.
4. Përveç gjuhës shqipe dhe gjuhës frënge që janë gjuhët zyrtare të njohura në kuadrin e marrëveshjes, institucionet kompetente mund të komunikojnë mes tyre në gjuhën angleze.

Neni 14

Referencat bankare

Përfituesit e benefiteve monetare dhe institucionet kompetente duhet t'ia komunikojnë institucionit kompetent debitor referencat bankare sipas normave ndërkombëtare (SWIFT CODE dhe/ose IBAN).

Neni 15

Rifitimi i pagesës së një benefiti

Në rastin kur, pas pezullimit të një përfitimi, i interesuari rifiton të drejtën e tij për përfitim, gjatë kohës kur ai banon në territorin e Shtetit tjetër kontraktues, institucionet kompetente shkëmbejnë informacionet e domosdoshme me qëllim ridhënien e pagesës së përfitimit.

Neni 16

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kjo marrëveshje administrative hyn në fuqi në të njëjtën datë si dhe ka të njëjtën kohëzgjatje si marrëveshja.

E bërë në ...30.03.2014..., më, në dy kopje, secila në gjuhën frënge dhe shqipe, të dy tekstet janë njëlloj autentike.

Për autoritetin kompetent
të Republikës së Shqipërisë

Yallca Breha
Breha

Për autoritetin kompetent
të Dukatit të Madh të Luksemburgut

f.i.

**ARRANGEMENT ADMINISTRATIF
RELATIF AUX MODALITÉS D'APPLICATION DE LA CONVENTION
EN MATIERE DE SÉCURITÉ SOCIALE**

ENTRE LA REPUBLIQUE D'ALBANIE ET LE GRAND-DUCHÉ DE LUXEMBOURG

En application du paragraphe 2 de l'article 18 de la convention en matière de sécurité sociale entre le Grand-Duché de Luxembourg et la République d'Albanie, signée à Luxembourg, le 27 octobre 2014, les autorités compétentes ont arrêté, d'un commun accord, les dispositions suivantes:

TITRE I – DISPOSITIONS GENERALES

Article 1er

Définitions

1. Pour l'application du présent arrangement administratif
 - a) le terme « convention » désigne la convention en matière de sécurité sociale entre la République d'Albanie et le Grand-Duché de Luxembourg, signée à Luxembourg, le 27 octobre 2014;
 - b) le terme « arrangement » désigne le présent arrangement administratif.
2. Les termes utilisés dans le présent arrangement ont la signification qui leur est attribuée à l'article 1er de la convention.

Article 2

Organismes de liaison

1. Conformément au paragraphe 3 de l'article 18 de la convention, sont désignés comme organismes de liaison :

pour le Grand-Duché de Luxembourg :

- l'Inspection générale de la sécurité sociale ;

pour la République d'Albanie :

- l'Institut de la Sécurité Sociale (Instituti i Sigurimeve Shoqërore).

2. Pour l'application de la convention les organismes de liaison désignés au paragraphe 1 peuvent communiquer directement entre eux ainsi qu'avec les personnes intéressées ou leurs mandataires.

3. Les organismes de liaison arrêtent d'un commun accord les procédures communes et les formulaires nécessaires pour l'application de la convention et du présent arrangement.

Article 3

Institutions compétentes

Pour l'application des législations visées au paragraphe 1 de l'article 2 de la convention, sont désignées comme institutions compétentes :

- A. Pour la République d'Albanie :

1. Pour les prestations en espèces des pensions de vieillesse, d'invalidité et de survie pour les salariés et pour les non-salariés, ainsi que pour les employeurs :
 - l'Institut de la Sécurité Sociale (Instituti i Sigurimeve Shoqërore) ;

2. Pour les prestations en nature de l'assurance maladie volontaire :

- la Caisse de l'Assurance Obligatoire des Soins Médicaux (Fondi i Sigurimit të Kujdesit të Detyrueshëm Shëndetësor).

B. Pour le Grand-Duché de Luxembourg

1. en ce qui concerne l'assurance pension en cas de vieillesse, d'invalidité et de survie:

- la Caisse nationale d'assurance pension,
- l'Administration du personnel de l'Etat, division du personnel retraité,
- la Caisse de prévoyance des fonctionnaires et employés communaux,
- la Société nationale des chemins de fer luxembourgeois, division du personnel retraité ;

2. pour l'application de l'article 8 du titre I, et du titre II de la convention :

- le Centre commun de la sécurité sociale ;

3. en ce qui concerne la constatation de l'invalidité :

- le Contrôle médical de la sécurité sociale.

Article 4

Attestation relative à la totalisation des périodes d'assurance

1. Pour l'application de l'article 6 de la convention et sous réserve de l'application des articles 14 à 16 de la convention, dans le cas où, pour l'acquisition, le maintien ou le recouvrement du droit aux prestations, il est nécessaire de prendre en compte des périodes d'assurance accomplies en vertu de la législation de l'autre Etat contractant, l'institution compétente de ce dernier Etat contractant établit un formulaire attestant les périodes d'assurance accomplies sous la législation qu'elle applique.

2. Ce formulaire est établi, soit à la demande de l'intéressé, soit à la demande de l'institution compétente de l'Etat contractant sur le territoire duquel l'intéressé se trouve.

Article 5

Demande d'admission à l'assurance maladie continuée volontaire

Pour l'application du paragraphe 2 de l'article 8 de la convention, l'institution compétente de l'Etat contractant qui est saisie d'une demande d'admission à l'assurance maladie continuée volontaire, peut s'adresser, directement ou par l'intermédiaire des organismes de liaison, à l'institution compétente de l'autre Etat contractant pour demander un formulaire attestant les périodes d'assurance accomplies sous la législation de cet Etat contractant.

TITRE II – DISPOSITIONS DETERMINANT LA LEGISLATION APPLICABLE

Article 6

Attestation concernant la législation applicable

1. Dans les cas visés à l'article 10 et au paragraphe 1 de l'article 11 de la convention, l'institution compétente de l'Etat contractant dont la législation est applicable délivre au travailleur, à la demande de celui-ci ou de l'employeur, un formulaire attestant qu'il reste soumis à cette législation. Le formulaire indique la période du détachement ou du travail temporaire sur le territoire de l'autre Etat contractant.
2. L'institution qui a délivré le formulaire visé au paragraphe 1 en remet un exemplaire validé au travailleur et à l'employeur, et en adresse une copie à l'institution compétente de l'autre Etat contractant. Les travailleurs doivent conserver le formulaire pendant leur séjour sur le territoire de l'autre Etat contractant pour le présenter, si nécessaire, à l'institution compétente de cet Etat contractant.
3. En cas de cessation anticipée de la période de détachement ou d'activité temporaire initialement prévue, le travailleur ou l'employeur doit en informer l'institution compétente de l'Etat contractant sur le territoire duquel le travailleur a été détaché ou a effectué temporairement un travail, par l'intermédiaire de l'institution qui a délivré le formulaire.

TITRE III – VIEILLESSE, INVALIDITE ET SURVIE

Article 7

Introduction des demandes de prestation

1. Pour bénéficier des prestations en vertu des dispositions du titre III de la convention, le requérant est tenu d'adresser une demande à l'institution compétente de l'Etat contractant sur le territoire duquel il réside, selon les modalités prévues par la législation que cette institution applique.
2. Si, au moment de l'introduction de la demande, aucune période d'assurance n'a été accomplie sous la législation de l'Etat contractant sur le territoire duquel le requérant réside, l'institution compétente doit transmettre sa demande sans délai à l'institution compétente de l'autre Etat contractant, soit directement, soit par l'intermédiaire des organismes de liaison.

Article 8

Instruction des demandes de prestation

1. Les institutions compétentes des Etats contractants se transmettent sans délai, directement ou par l'intermédiaire des organismes de liaison, les demandes ainsi que tout autre document disponible qui peut être nécessaire pour l'instruction de la demande, moyennant un formulaire conçu à cet effet. Chaque institution compétente transmet également un formulaire attestant les périodes d'assurance accomplies sous sa législation à l'institution compétente de l'autre Etat contractant.

2. Avant la transmission visée au paragraphe 1, l'institution compétente de l'Etat contractant qui a reçu une demande de prestation, inscrit sur la demande la date d'entrée et atteste l'exactitude des données personnelles. Cette procédure tient lieu de transmission de pièces justificatives.

Article 9

Notification des décisions

Chaque institution compétente détermine les droits du requérant d'après les dispositions du titre III de la convention et notifie à l'intéressé la décision afférente avec indication des voies et délais de recours, tout en transmettant en même temps une copie à l'institution compétente de l'autre Etat contractant.

Article 10

Paiement des pensions

1. Les prestations à charge d'une institution compétente de l'un des Etats contractants sont payées directement au bénéficiaire résidant sur le territoire de l'autre Etat contractant, aux échéances prévues par la législation que cette institution applique.

2. Le paiement se fait conformément à l'article 23 de la convention, sans aucune déduction pour frais d'administration pouvant être encourus aux fins du paiement d'une prestation. Toutefois, les frais bancaires sont à charge du titulaire de pension.

3. Les bénéficiaires de prestations sont tenus de transmettre à l'institution débitrice de la prestation, soit directement, soit par l'intermédiaire des organismes de liaison, tous les douze mois, un certificat de vie délivré par les autorités de l'Etat contractant sur le territoire duquel ils résident.

Article 11

Statistiques

Les organismes de liaison échangent des statistiques annuelles sur le nombre des prestations versées dans l'autre Etat contractant ainsi que sur le montant afférent.

TITRE IV - DISPOSITIONS DIVERSES

Article 12

Contrôle médical et administratif

1. En application des paragraphes 3 et 4 de l'article 19 de la convention, le contrôle médical et administratif des bénéficiaires de prestations de l'un des Etats contractants résidant sur le territoire de l'autre Etat contractant est effectué à la demande de l'institution compétente par les soins de l'institution du lieu de résidence, selon les modalités prévues par la législation que cette dernière institution applique.

2. Sur demande d'une institution compétente de l'un des Etats contractants, l'institution compétente de l'autre Etat contractant communique gratuitement toute information d'ordre médical et toute documentation en sa possession relatives à l'invalidité du requérant ou du bénéficiaire de prestations.

3. Les institutions compétentes conservent toutefois le droit de faire procéder à l'examen de l'intéressé par un médecin de leur choix.

4. Les frais résultant du contrôle administratif, ainsi que des examens médicaux, des mises en observation, des déplacements des médecins et des enquêtes administratives ou médicales nécessaires à l'octroi, au service ou à la révision des prestations, sont remboursés à l'institution qui en a été chargée, sur la base du tarif qu'elle applique, par l'institution pour le compte de laquelle ils ont été effectués.

5. Les organismes de liaison des deux Etats contractants peuvent, avec l'accord des autorités compétentes respectives, convenir de renoncer au remboursement des frais visés au paragraphe 4.

Article 13

Echange d'informations

1. Les bénéficiaires de prestations accordées au titre de la législation de l'un des Etats contractants qui résident sur le territoire de l'autre Etat contractant communiquent à l'institution compétente, soit directement, soit par l'intermédiaire des organismes de liaison, tout changement concernant leur situation personnelle ou familiale, leur état de santé, leur capacité de travail, leurs revenus ainsi que toute autre circonstance susceptible d'influencer leurs droits ou obligations au regard des législations mentionnées à l'article 2 de la convention et au regard des dispositions de la convention.

2. Les institutions se communiquent, soit directement, soit par l'intermédiaire des organismes de liaison tout renseignement analogue dont elles auraient connaissance.

3. Dans leurs communications, les institutions compétentes privilégient l'emploi des moyens électroniques.

4. En outre de l'albanais et du français qui sont les langues officielles reconnues dans le cadre de la convention, les institutions compétentes peuvent communiquer entre elles en anglais.

Article 14

Références bancaires

Les bénéficiaires de prestations en espèces et les institutions compétentes sont tenus de communiquer à l'institution compétente débitrice les références bancaires selon les normes internationales (SWIFT CODE et/ou IBAN).

Article 15

Reprise du paiement d'une prestation

Lorsque, après suspension d'une prestation, l'intéressé recouvre son droit à prestation alors qu'il réside sur le territoire de l'autre Etat contractant, les institutions compétentes échangent les renseignements indispensables en vue de la reprise du paiement de la prestation.

Article 16


Entrée en vigueur et durée

Le présent arrangement entre en vigueur à la même date que la convention et a la même durée.

Fait à, le, en double exemplaire, chacun en langues française et albanaise, les deux textes faisant également foi.

Pour l'autorité compétente

de la République d'Albanie

Handwritten signature in dark ink, appearing to read "Vjollca Basha".

Pour l'autorité compétente

du Grand-Duché de Luxembourg

Handwritten signature in dark ink, consisting of a stylized initial and a long horizontal stroke.